



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 1 korrik 2014  
Nr.ref.:AGJ671/14

## **AKTGJYKIM**

në

**Rastin Nr. KO103/14**

Parashtrues

**Presidentja e Republikës së Kosovës**

**Përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14)  
[Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të  
Kushtetutës së Republikës së Kosovës**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Saj, Atifete Jahjaga (në tekstin e mëtejme: Parashtruesja e kërkesës).

## Objekti i çështjes

2. Parashtrësja përmban kërkesën për vlerësim të përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).
3. Objekt i çështjes janë këto pyetje që i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) nga parashtrësja e kërkesës:
  - a. *Definicioni i fjalës "ka fituar", si është përdorur në nenin 95, paragrafi 1, të Kushtetutës?*
    - i. *Mbi çfarë baze përcaktohet partia politike apo koalicioni që "ka fituar" zgjedhjet sipas kësaj dispozite kushtetuese, kush e bën këtë përcaktim dhe mbi çfarë baze?*
    - ii. *A matet atributi kushtetues i partisë politike ose koalicionit që "ka fituar" shumicën në Kuvend sipas nenit 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, me veprimet e tyre para ose pas ditës së zgjedhjeve? A ndikon certifikimi i rezultateve në përgjigjen e kësaj pyetjeje?*
    - iii. *A mund të ndryshohet atributi kushtetues i partisë politike ose i koalicionit që "ka fituar" shumicën në Kuvend sipas nenit 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, pas zgjedhjeve dhe, nëse po, si?*
    - iv. *Cilët janë prerogativët kushtetues të partisë politike ose të koalicionit që "ka fituar" shumicën në Kuvend sipas nenit 95, paragrafi 1, të Kushtetutës?*
  - b. *Definoni frazën "e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë", siç është shkruar në nenin 95, paragrafi 1, të Kushtetutës?*
  - c. *Qartësoni frazën "sipas të njëjtës procedurë", siç është përdorur në nenin 95, paragrafi 4, të Kushtetutës?*
    - i. *A do të thotë kjo që kandidati duhet të propozohet në konsultim me partinë e njëjtë ose koalicionin sikur herën e parë (neni 95, paragrafi 1, i Kushtetutës) apo ky kandidat mund të propozohet në konsultim me ndonjë parti ose koalicion tjetër?*
    - ii. *A mundet që kandidati i propozuar herën e dytë të jetë person që nuk është anëtar i partisë me të cilën janë zhvilluar konsultimet sipas nenit 95, paragrafët 1 dhe 5, të Kushtetutës?*
    - iii. *A mundet që kandidati i propozuar sipas nenit 95, paragrafi 4, i Kushtetutës të jetë personi që nuk i takon asnjë partie politike?*
  - ç. *Defino frazën "shumicën në Kuvend" siç është shkruar në nenin 84, paragrafi 14, të Kushtetutës?*



- i. A nënkupton kjo frazë partinë ose koalicionin që ka 51 % të shumicës së Kuvendit ose partinë ose koalicionin që ka më së shumti deputetë në Kuvend?
- ii. Nëse përgjigja në pyetjet paraprake është që partia ose koalicioni me më së shumti deputetë në Kuvend përbënë "shumicën në Kuvend" sipas nenit 84, paragrafi 14, nëse një parti ose koalicion të dyja kanë shumicën, cila ka përparësi?
- iii. A dallon fraza "shumicën në Kuvend" në ndonjë mënyrë nga fraza "shumicën e Kuvendit"? [Theksi i shtuar]?
- iv. Si duhet Presidentja të konfirmojë që një parti ose një koalicion përbën shumicën në Kuvend?
- d. Së fundi dhe me më rëndësi, ju lutem specifikoni rendin e përparësisë ndërmjet nenit 84, paragrafi 14, dhe nenit 95 të Kushtetutës ashtu siç ato lidhen me kompetencën e Presidentes për të mandatuar kandidatin për Kryeministër pas zgjedhjeve?

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenet 84.9 dhe 113, paragrafët 3.1 dhe 3.5, të Kushtetutës dhe në rregullin 56.1 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 19 qershor 2014, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 20 qershor 2014, në mbështetje të rregullit 33 të Rregullores së punës, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KO103/14, e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KO103/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 20 qershor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës.
8. Të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Qeverisë në detyrë të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria në detyrë) dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit). Këtij të fundit i është kërkuar të dorëzojë në Gjykatën Kushtetuese një kopje të *Travaux Preparatoires* (punëve përgatitore) të Kushtetutës, lidhur me nenin 84 (14) dhe me nenin 95 të Kushtetutës.

9. Po të njëjtën datë, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit iu përgjigj Gjykatës, duke thënë se nuk i kishin *Travaux Preparatoires* (punët përgatitore) të Kushtetutës, lidhur me nenin 84 (14) dhe me nenin 95 të Kushtetutës.
10. Më 23 qershor 2014, Gjykata kërkoi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejme: KQZ) dokumentet dhe informacionet vijuese:
  - a. Vendimet e KQZ-së për certifikimin e partive politike, të organizatave joqeveritare, të kandidatëve të pavarur dhe të koalicioneve që nga zgjedhjet e para parlamentare në Kosovën e pasluftës e deri më sot;
  - b. Certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve që nga zgjedhjet e para parlamentare në Kosovën e pasluftës e deri më sot; dhe
  - c. Rezultati i zgjedhjeve, që nga zgjedhjet e para parlamentare në Kosovën e pasluftës e deri më sot, a i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës?
11. Më 24 qershor 2014, KQZ-ja iu përgjigj Gjykatës, duke dorëzuar dokumentet dhe informacionet e kërkuara.
12. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën për përjashtimin e tij nga seancat e këshillimeve për periudhën qershor-korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë lidhur me pretendimet e caktuara të ngritura ndaj tij.
13. Më 30 qershor 2014, Gjykata mbajti këshillime dhe votoi lidhur me rastin.

#### **Pranueshmëria e kërkesës**

14. Për të qenë në gjendje të vendosë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në Rregullore të punës.
15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, që përcakton: *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”*
16. Parashtruesi i kërkesës argumenton:

“...

*[...] Siç u theksua më lart, neni 84, paragrafi 9, i Kushtetutës përcakton kompetencën për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese. Kjo kompetencë e përcaktuar e Presidentes sipas dispozitës kushtetuese të lartpërmendur është e gjerë në kuptim dhe nuk i nënshtrohet asnjë rezervimi, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet specifike të renditura në nenin 113 të Kushtetutës. Andaj, mund të konstatohet se Presidentja e Kosovës mund të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese nëse një çështje e tillë është nën jurisdiksionin e Gjykatës Kushtetuese, me kushtin që këto pyetje të ndërlidhen me interpretimin e Kushtetutës ose vlerësimin e*



përputhshmërisë së ligjeve dhe akteve tjera me Kushtetutën, siç e parasheh neni 112 i Kushtetutës.

Përkundër faktit që jurisdiksioni i Gjykatës Kushtetuese rregullohet posaçërisht sipas nenit 113, kufiri i jashtëm i kompetencës së Gjykatës Kushtetuese është i përcaktuar me nenin 112 të Kushtetutës, që parasheh se "Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën." [Theksi i shtuar]. Mandati që i është dhënë Gjykatës Kushtetuese për të qenë autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës, sipas nenit 112 të Kushtetutës, barte përgjegjësinë për Gjykatën Kushtetuese që jo vetëm të sigurojë përputhshmërinë e ligjeve dhe akteve tjera me Kushtetutën, por që gjithashtu të garantojë zbatim konsistent të dispozitave kushtetuese dhe të shmangë çfarëdo konflikti ndërmjet këtyre dispozitave. Duke marrë parasysh rëndësinë e mandatit të Gjykatës Kushtetuese për të siguruar konsistencën e normave kushtetuese me njëra tjetrën, Gjykata Kushtetuese është e detyruar të ushtrojë këtë funksion kurdo që një çështje rreth përputhshmërisë së normave kushtetuese i adresohet saj nga autoritetet që janë të mandatuara të zbatojnë dispozita të caktuara kushtetuese. Pikërisht, qëllimi i nenit 84, paragrafi 9, të Kushtetutës është t'i mundësojë Presidentes të referojë çështje rreth përputhshmërisë dhe konsistencës së dispozitave kushtetuese gjatë ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të mandatuara me Kushtetutë. Ky argument vërtetohet nga fakti që një e drejtë e ngjashme i është dhënë Qeverisë së Kosovës sipas nenit 93, paragrafi 10, të Kushtetutës. Kjo dëshmon që qëllimi i normave të lartpërmendura kushtetuese është t'i japin institucioneve, kompetencat e të cilave rrjedhin nga dhe renditen në Kushtetutë, me autoritetin për të ngritur çështje në Gjykatën Kushtetuese me qëllim që t'ua mundësojë atyre ushtrimin e funksioneve në përputhje të plotë me gjuhën dhe frymën e Kushtetutës.

Duke marrë parasysh këtë, është e qartë që kërkesa e parashtruar në Gjykatën Kushtetuese nga Presidentja e Kosovës sipas nenit 84, paragrafi 9, të Kushtetutës, mbi vlerësimin e përputhshmërisë së normave kushtetuese që lidhen me ushtrimin e mandatit të saj është e pranueshme. Një kërkesë e këtillë do të duhej të konsiderohej si e pranueshme për këto arsye: (i) Presidentja e Kosovës është e mandatuara të referoj çështje të tilla sipas nenit 84, paragrafi 9, i Kushtetutës; (ii) natyra e çështjeve është ekskluzivisht kushtetuese pasi që ato lidhen me kompetencat kushtetuese të Presidentes; dhe (iii) çështjet kanë për qëllim që të sigurojnë zbatim konsistent të kompetencave që Kushtetuta i ka dhënë Presidentes. Në lidhje me këtë, duhet theksuar se Gjykata Kushtetuese në rastin Nr. KO 98/ 11, kur ka shqyrtuar pranueshmërinë e kërkesës së bërë nga Qeveria e Kosovës sipas nenit 93, paragrafi 10 - që është identik me nenin 84, paragrafi 9, të Kushtetutës -ka vendosur që "nëse çështjet janë çështje kushtetuese atëherë Qeveria do të jetë palë e autorizuar dhe kërkesa do të jetë e pranueshme." Kjo dëshmon që Gjykata Kushtetuese e ka njohur rëndësinë e rolit aktiv që kanë palët e autorizuar për të ngritur çështje të natyrës kushtetuese që i mundëson Gjykatës Kushtetuese të ushtrojë mandatin e saj për të interpretuar Kushtetutën me qëllim të ruajtjes së konsistencës së vet. Pra, vetëm për këtë arsye, kjo kërkesë duhet të shpallet e pranueshme.



Pa paragjykim të analizës së lartpërmendur, duhet të theksohet që autoriteti i Presidentes për të parashtruar këtë kërkesë gjithashtu tërthorazi rrjedhë nga neni 113, paragrafi 3, pika 1 dhe 5, e Kushtetutës. Siç dihet, pika 1 e nenit 113, paragrafi 3, e Kushtetutës flet për konfliktin në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit, Presidentes dhe Qeverisë. Ndonëse gjuha e kësaj dispozite kushtetuese është e kufizuar në konfliktet e jashtme në ushtrimin e kompetencave të institucioneve të lartpërmendura, vlera që kërkohet të mbrohet është zbatimi konsistent i Kushtetutës, e cila gjithashtu mund të cungohet kur ekziston një konflikt i brendshëm në ushtrimin e kompetencave kushtetuese të këtyre institucioneve. Meqë kjo kërkesë lidhet me ushtrimin e kompetencave të Presidentes për të mandatuar kandidatin për Kryeministër pas zgjedhjeve, është e qartë që një pyetje e tillë bie përbrenda vlerës që synohet të mbrohet nga neni 113, paragrafi 3, i Kushtetutës. Pra, vetëm për këtë arsye, kjo kërkesë duhet të shpallet e pranueshme.

Për më shumë, kërkesa duhet të shpallet e pranueshme sipas pikës 5 të nenit 113, paragrafi 3, të Kushtetutës meqë çështja ka për qëllim të parandalojë shkelje të Kushtetutës gjatë procesit të krijimit të institucioneve të zgjedhura në mënyrë demokratike, siç janë Kuvendi dhe Qeveria. Norma e lartpërmendur ligjore e autorizon Presidenten të ngrisë çështje se a është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit. Vlera që mbrohet nga kjo dispozite kushtetuese është zbatim i plotë i kushtetutshmërisë gjatë procesit më të rëndësishëm për secilën shoqëri demokratike, zgjedhja e institucioneve të saj përfaqësuese dhe qeverisëse. Duke marrë parasysh rolin e Presidentes si garantues i funksionimit kushtetutes të institucioneve, të mishëruar në nenin 84 të Kushtetutës, është detyrim i Presidentes të sigurojë jo vetëm që shkeljet e tilla të adresohen kurdo që ndodhin, por edhe të parandalohen kurdo që kjo është e mundur. Në këtë drejtim, mënyra më e matur për të proceduar tutje me rastin e një ballafaqimi të tillë të mospërputhshmërisë direkte të dy normave kushtetuese gjatë ushtrimit të autoritetit të mandatuar nga kjo Kushtetutë është që të kërkohet udhëzim nga Gjykata Kushtetuese në përputhje me nenin 84, paragrafin 9, të Kushtetutës. Mbi këtë bazë, kjo kërkesë duhet të shpallet e pranueshme qoftë edhe vetëm për këtë arsye.

...

17. Rrjedhimisht, parashtruesja argumenton se, në rastin konkret, janë plotësuar kriteret e specifikuar në nenin 84 (9), në nenin 113.3.1 dhe në nenin 113.3.5 të Kushtetutës.
18. Neni 84 (9) i Kushtetutës thotë:

**“Neni 84 [Kompetencat e Presidentit]**

*Presidenti i Republikës së Kosovës...*

*(9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese...”.*

19. Prandaj, në përputhshmëri me nenin 84 (9) të Kushtetutës, Presidenti i Republikës së Kosovës është i autorizuar të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese.
20. Andaj, Gjykata duhet të vlerësojë nëse çështjet e shtruarra janë “çështje kushtetuese”, sipas nenit 84 (9) të Kushtetutës.
21. Për të vlerësuar si duhet këtë çështje, është e nevojshme një përmbledhje e historisë faktike të rastit, që shkaktoi parashtrimin e këtyre pyetjeve në Gjykatën Kushtetuese.

### **Përmbledhje e fakteve lidhur me pyetjet në fjalë**

22. Më 7 maj 2014, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën e jashtëzakonshme plenare, vendosi për shpërbërjen e legjislaturës së katërt të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
23. Më 8 maj 2014, Presidentja e Republikës së Kosovës, dekretoi zgjedhjet e parakohshme që do të mbaheshin më 8 qershor 2014.
24. Më 8 qershor 2014, u mbajtën zgjedhjet në Republikën e Kosovës.
25. Më 27 qershor 2014, KQZ-ja publikoi rezultatet e zgjedhjeve.

### **Konkluzioni për pranueshmërinë**

26. Nuk është detyrë e Gjykatës të vlerësojë faktet e një rasti të caktuar, por faktet e lartpërmendura duket të kenë ngritur çështje kushtetuese lidhur me dy dispozitat kushtetuese, pra të nenit 84 (14) dhe të nenit 95 të Kushtetutës.
27. Rrjedhimisht, në bazë të nenit 84 (9) të Kushtetutës, Gjykata gjen se pyetjet e parashtruara nga parashtruesja e kërkesës janë të natyrës kushtetuese. Ato kanë për qëllim sigurimin e aplikimit konsistent të kompetencave të Presidentit të Republikës, të mandatuara me Kushtetutë, në pajtim me shkronjën dhe me frymën e Kushtetutës.
28. Duke marrë parasysh këto vlerësime, Gjykata konsideron se nuk ka bazë për të deklaruar kërkesën, e cila ngrit çështje të rëndësishme kushtetuese, të papranueshme ose për t'u lëshuar në baza shtesë të pranueshmërisë, të paraqitura nga parashtruesja e kërkesës.

### **Analiza krahasimtare**

29. Para se të hyjë në analizimin e çështjeve kushtetuese, Gjykata do të bëjë një studim krahasues të dispozitave kushtetuese të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (në tekstin e mëtejshëm: Korniza Kushtetuese) si dhe të një varg shtetesh fqinje dhe të tjera.

### ***Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë***

30. Korniza Kushtetuese, në nenin 9.1.26 dhe në nenin 9.2.4, parasheh:



## **Kreu 9 – Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes**

### **Pjesa 1: Kuvendi**

#### **Përgjegjësitë e Kuvendit**

9.1.26 Kuvendi ka përgjegjësitë e mëposhtme:

- (d) Miraton ose refuzon kandidatin për Kryeministër, së bashku me listën e ministrave të Qeverisë së propozuar nga kandidati për Kryeministër;

### **Pjesa 2: Kryetari i Kosovës**

9.2.4 Kryetari i Kosovës, duke u mbështetur në këtë Kornizë Kushtetuese dhe në ligjin e zbatueshëm, ushtron këto funksione:

- (b) Pas konsultimeve me partitë politike të përfaqësuara në Kuvend ia propozon Kuvendit Kryeministrin e Qeverisë;

### **Shqipëria**

31. Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 96, parasheh:

1. Presidenti i Republikës, në fillim të legjislaturës, si dhe kur vendi i Kryeministrit mbetet vakant, emëron Kryeministrin me propozim të partisë ose koalicionit të partive, që ka shumicën e vendeve në Kuvend.
2. Në qoftë se Kryeministri i emëruar nuk miratohet nga Kuvendi, Presidenti emëron një Kryeministër të ri brenda 10 ditëve.
3. Në qoftë se edhe Kryeministri i emëruar rishtas nuk miratohet nga Kuvendi, brenda 10 ditëve Kuvendi zgjedh një Kryeministër tjetër. Në këtë rast Presidenti emëron Kryeministrin e ri.
4. Kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Kryeministrin e ri, Presidenti i Republikës shpërndan Kuvendin.

### **Bullgaria**

32. Kushtetuta e Republikës së Bullgarisë, në nenin 99, parasheh:

1. Pas konsultimeve me grupet parlamentare, Presidenti cakton mandatarin për Kryeministër të nominuar nga partia që mban numrin më të madh të ulëseve në Asamblenë Kombëtare për të formuar qeverinë.
2. Në qoftë se mandatarin për Kryeministër dështon në formimin e qeverisë brenda shtatë ditësh, Presidenti do t'ia besoj këtë detyrë mandatarit për Kryeministër të nominuar nga grupi i dytë më i madh parlamentar.



3. Në qoftë se mandatarin e ri për Kryeministër poashtu dështon në formimin e qeverisë brenda periudhës së paraparë në paragrafin paraprak, Presidenti do t'ia besojë detyrën mandatarit për Kryeministër të nominuar nga njëra prej grupeve parlamentare pakicë.
4. Në qoftë se konsultimet rezultojnë të suksesshme, Presidenti do të kërkojë nga Asambleja Kombëtare që të zgjedhë mandatarin për kryeministër.
5. Në qoftë se nuk arrihet asnjë marrëveshje për formimin e qeverisë, Presidenti do të caktojë qeveri në detyrë, të shpërbëjë Asamblenë Kombëtare dhe caktojë zgjedhjet brenda afatit të paraparë me nenin 64 paragrafi 3. Akti i Presidentit për shpërbërjen e Asamblesë Kombëtare poashtu cakton edhe datën për zgjedhjet e përgjishme.
6. Procedura për formimin e qeverisë e përcaktuar me paragrafët paraprak më pastaj aplikohet në rastet e referuara në nenin 111 paragrafi 1.
7. Në rastet e referuara në paragrafët 5 dhe 6, Presidenti nuk shpërbën Asamblenë Kombëtare gjatë tre muajve të fundit të mandatit të saj. Në qoftë se Parlamenti dështon të formojë qeverinë brenda periudhës së paraparë, Presidenti cakton një qeveri në detyrë.

## **Kroacia**

33. Kushtetuta e Kroacisë, në nenet 98, 110, 111 dhe 112, parasheh:

### **Neni 98**

#### **Presidenti i Republikës:**

- Shpall zgjedhjet për Parlamentin Kroat dhe thërret seancën e tij të parë;
- Shpall referendumin, në pajtueshmëri me Kushtetutën;
- I beson mandatin për formimin e qeverisë personit i cili, sipas ndarjes së ulëseve në Parlamentin Kroat dhe konsultimeve të mbajtura, gëzon besimin e shumicës së anëtarëve të tij;
- Jep falje;
- Jep dekorata dhe çmime të tjera të specifikuara me ligj;
- Kryen detyra të tjera të parapara me Kushtetutë.

### **Neni 110**

Anëtarët e qeverisë i propozon personi të cilit Presidenti i Republikës i ka besuar mandatin për formimin e qeverisë.

- Menjëherë pas formimit të qeverisë, por jo më vonë se 30 ditë nga pranimi i mandatit, mandatarin është i obliguar që t'i paraqesë Parlamentit Kroat qeverinë dhe programin e saj dhe të kërkojë votëbesimin.

- *Qeveria do të marrë detyrat e saja kur të fitojë besimin e shumicës së të gjithë anëtarëve të Parlamentit Kroat.*
- *Kryeministri dhe anëtarët qeverisë do të bëjnë betimin solem para Parlamentit Kroat. Teksti i betimit përcaktohet me ligj.*
- *Në bazë të vendimit të Parlamentit Kroat për shprehjen e besimit qeverisë së Republikës së Kroacisë, vendimin për emërimin e Kryeministrit e sjellë Presidenti i Republikës, bashkë me nënshkrimin e Presidentit të Parlamentit Kroat, dhe vendimin për emërimin e anëtarëve të qeverisë e sjellë Kryeministri bashkë me nënshkrimin e Presidentit të Parlamentit Kroat.*

#### *Neni 111*

*Në qoftë se mandatar i dështon të formojë qeverinë brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të mandatit, Presidenti i Republikës mund të vendosë për zgjatjen e afatit për jo më shumë se 30 ditë shtesë.*

*Në qoftë se mandatar i dështon të formojë qeverinë edhe gjatë afatit shtesë, ose në qoftë se qeveria e propozuar nuk arrin të fitojë besimin e Parlamentit Kroat, Presidenti i Republikës i beson mandatin për formimin e qeverisë një personi tjetër.*

#### *Neni 112*

*Në qoftë se qeveria nuk formohet në pajtueshmëri me nenet 110 dhe 111 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës emëron qeverinë e përkohshme jopartiake dhe njëkohësisht shpall zgjedhjet e parakohshme për Parlamentin Kroat.*

### **Gjermania**

34. Ligji Themelor i Republikës së Gjermanisë, në nenin 63, përcakton:

#### *Neni 63 [Zgjedhja e Kancelarit Federal]*

1. *Kancelari Federal emërohet nga Bundestagu pa debatuar për propozimin e Presidentit Federal.*
2. *Zgjidhet personi që merr votat e shumicës së Anëtarëve të Bundestagut. Personi i zgjedhur emërohet nga Presidenti Federal.*
3. *Nëse personi i propozuar nga Presidenti Federal nuk është zgjedhur, Bundestagu mund të zgjedhë një Kancelar Federal brenda katërmëdhjetë ditësh pas votimit nga votat e më shumë se gjysmës së anëtarëve të vet.*
4. *Nëse brenda kësaj periudhe nuk zgjidhet Kancelari Federal, zgjedhjet e reja duhet të zhvillohen pa vonesë, në të cilat zgjidhet personi që merr*



numrin më të madh të votave. Nëse personi i zgjedhur merr votat e shumicës së Anëtarëve të Bundestagut, Presidenti Federal emëron atë brenda shtatë ditëve pas zgjedhjeve. Nëse personi i zgjedhur nuk merr një shumicë të tillë, atëherë brenda shtatë ditësh Presidenti Federal ose emëron atë ose shpërndan Bundestagun.

## **Greqia**

35. Kushtetuta e Greqisë, në nenin 37, përcakton:

### *Neni 37*

1. Presidenti i Republikës emëron Kryeministrin dhe me rekomandimin e tij emëron dhe shkarkon anëtarët e tjerë të Kabinetit dhe Nënsekretarët.
2. Lideri i partisë që ka shumicën absolute të vendeve në Parlament emërohet Kryeministër. Në qoftë se asnjë parti nuk ka shumicën absolute, Presidenti i Republikës do t'i japë liderit të partisë me një shumicë relative një mandat eksplorues në mënyrë që të përcaktojë mundësinë e formimit të një Qeverie që gëzon konfidencën e Parlamentit.
3. Nëse kjo mundësi nuk mund të përcaktohet, Presidenti i Republikës i jep mandatin eksplorues liderit të partisë së dytë më të madhe në Parlament, dhe nëse kjo dëshkohet si jo e suksesshme, atëherë partisë së tretë më të madhe në Parlament. Secili mandat eksplorues mbetet në fuqi për tri ditë. Nëse të gjitha mandatet eksploruese dëshkohen si jo të suksesshme, Presidenti i Republikës fton të gjithë liderët e partive, dhe në qoftë se konfirmohet pamundësia për të formuar një Kabinet që gëzon konfidencën e Parlamentit, ai do të përpiqet të formojë një Kabinet të përbërë nga të gjitha partitë në Parlament me qëllim të mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare. Nëse kjo dështon ai do t'ia besojë Kryetarit të Gjykatës Supreme Administrative apo të Gjykatës Civile Supreme dhe Gjykatës Penale, apo të Gjykatës së Auditimit për të formuar një Kabinet si të pranuar sa më gjerësisht që është e mundur për të kryer zgjedhjet dhe shpërbën Parlamentin.
4. Në rastet që mandati për të formuar një Kabinet ose një mandat eksplorues është dhënë në përputhje me paragrafët e lartpërmendur, nëse partia nuk ka lider ose zëdhënës të partisë, ose në qoftë se lideri apo zëdhënësi nuk është zgjedhur në Parlament, Presidenti i Republikës i jep mandatin një personi të propozuar nga grupi parlamentar i partisë. Propozimi për caktimin e mandatit duhet të ndodhë brenda tri ditëve nga dita e komunikimit të Kryetarit të Kuvendit ose zëvendësit të tij me Presidentin e Republikës përkitazi me numrin e vendeve të poseduara nga çdo secila parti në Parlament; komunikimi i sipërpërmendur duhet të ndodhë para se të jetë dhënë çfarëdo mandati.

## **Maqedonia**

36. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, në nenet 84 dhe 90, përcakton:

#### Neni 84

*Presidenti i Republikës së Maqedonisë*

- Cakton mandatarin për formimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

#### Neni 90

*Kryetari i Republikës së Maqedonisë është i obliguar që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e konstituimit të Kuvendit, mandatin për formimin e Qeverisë t'ia besojë kandidatit të partisë, përkatësisht të partisë/partive që ka/kanë shumicën në Kuvend.*

*Mandatarin, në afat prej 20 ditësh nga dita e besimit të mandatis, Kuvendit ia paraqet programin dhe i propozon përbërjen e Qeverisë.*

*Qeverinë, me propozimin e mandatarit dhe në bazë të programit, e zgjedh Kuvendi me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.*

### **Portugalia**

37. Kushtetuta e Portugalisë, në nenin 187, përcakton:

#### *Titulli IV - Qeveria*

#### *Kapitulli II. Formimi dhe përgjegjësitë*

#### *Neni 187 Formimi*

1. *Presidenti i Republikës emëron Kryeministrin pas konsultimit me partitë me vende në Kuvendin e Republikës dhe në dritën e rezultateve zgjedhore.*
2. *Presidenti i Republikës emëron anëtarët e mbetur të Qeverisë me propozim nga ana e Kryeministrit.*

### **Sllovenia**

38. Kushtetuta e Republikës së Sllovenisë, në nenin 111, përcakton:

#### *Neni 111. Zgjedhja e Kryetarit të Qeverisë*

*Pas konsultimit me liderët e grupeve parlamentare, Presidenti i Republikës i propozon Kuvendit Kombëtar kandidatin për Kryetar të Qeverisë.*

*Kryetari i Qeverisë zgjidhet nga Kuvendi Kombëtar me shumicën e votave të të gjithë deputetëve përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë Kushtetutë. Votimi është i fshehtë.*

*Nëse kandidati i tillë nuk merr shumicën e nevojshme të votave, Presidenti i Republikës, pas përsëritjes së konsultimeve, mund të propozojë brenda katërmëdhjetë ditësh një kandidat të ri ose të njëjtin kandidat sërish, po*



*ashtu kandidatët mund të propozohen edhe nga grupet parlamentare ose së paku nga dhjetë deputetë. Nëse brenda kësaj periudhe janë propozuar disa kandidatë, për secilin votohet veç e veç, duke filluar me kandidatin e propozuar nga Presidenti i Republikës, dhe nëse ky kandidat nuk zgjidhet, votohet për kandidatët tjerë sipas rendit të propozimit të tyre.*

*Nëse nuk zgjidhet asnjë kandidat, Presidenti Republikës e shpërndan Kuvendin Kombëtar dhe thërret zgjedhje të reja, përveç nëse brenda katërdhjetë e tetë orësh Kuvendi Kombëtar me shumicën e votave të hedhura nga deputetët e pranishëm vendos të mbajë zgjedhje të reja për Kryetarin e Qeverisë, ku shumica e votave të hedhura nga deputetët e pranishëm është e mjaftueshme për zgjedhjen e kandidatit. Në rast të zgjedhjeve të tilla të reja, votohet individualisht për kandidatët sipas radhitjes së numrit të votave të fituara në votimin e mëhershëm dhe pastaj për kandidatët e rinj të propozuar para votimit të ri, ku cilido kandidat që propozohet nga Presidenti i Republikës ka përparësi.*

*Nëse në zgjedhjet e tilla asnjë kandidat nuk merr numrin e nevojshëm të votave, Presidenti i Republikës e shpërndan Kuvendin Kombëtar dhe thërret zgjedhje të reja.*

## **Historiku i zgjedhjeve në Kosovë**

39. Më 17 nëntor 2001, Kosova mbajti zgjedhjet e para të përgjithshme parlamentare sipas dispozitave të Kornizës Kushtetuese. LDK (Lidhja Demokratike e Kosovës) fitoi 46.2 % të votave, duke marrë 47 vende në Parlament. Partia e dytë më e madhe ishte PDK-ja (Partia Demokratike e Kosovës) që fitoi 25.5 % të votave, prandaj fitoi 26 vende në Parlament, e pasuar nga Aleanca Kthimi, që fitoi 10.9 % të votave, duke marrë 22 vende në Parlament, dhe AAK (Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës) që fitoi 7.8 % të votave, duke marrë 8 vende në Parlament.
40. LDK nuk arriti të merrte mbështetjen e mjaftueshme për të qeverisur vetëm. Pas këtij dështimi, LDK-ja u tërhoq nga kërkesa për të pasur postin e Kryeministrit dhe u pajtua të nominojë si mandatar për Kryeministër z. Bajram Rexhepi nga partia e dytë më e madhe, përkatësisht nga PDK-ja. Në pajtim me Kornizën Kushtetuese, neni 9.2.4 (b), Kryetari i Kosovës i propozoi Kuvendit z. Bajram Rexhepi për Kryeministër, i cili mori mbështetjen e Kuvendit në pajtim me nenin 9.1.26 (d).
41. Më 23 tetor 2004, Kosova mbajti zgjedhjet e dyta të përgjithshme parlamentare sipas dispozitave të Kornizës Kushtetuese. Në bazë të informacionit të marrë nga KQZ-ja, Gjykata vëren se LDK fitoi 45.42 % të votave, duke marrë 47 vende në Kuvend, PDK-ja fitoi 28.85 % të votave, duke marrë 30 vende në Kuvend, AAK-ja fitoi 8.39 % të votave, duke marrë 9 vende në Kuvend, dhe ORA fitoi 6.2 % të votave, duke marrë 7 vende në Kuvend.
42. LDK nuk arriti të merrte mbështetjen e mjaftueshme për të qeverisur vetëm. Pas këtij dështimi, LDK u tërhoq nga kërkesa për të pasur postin e Kryeministrit dhe u pajtua të nominojë z. Ramush Haradinaj si mandatar për Kryeministër, nga partia e tretë më e madhe, përkatësisht nga AAK-ja. Në



pajtim me Kornizën Kushtetuese, neni 9.2.4 (b), Kryetari i Kosovës i propozoi Kuvendit z. Ramush Haradinaj për Kryeministër, i cili mori mbështetjen e Kuvendit në pajtim me nenin 9.1.26 (d).

43. Më 17 nëntor 2007, Kosova mbajti zgjedhjet e treta të përgjithshme parlamentare sipas dispozitave të Kornizës Kushtetuese. Në bazë të informacioneve të marra nga KQZ-ja, Gjykata vëren se PDK-ja mori 37 vende në Kuvend, ndërsa LDK-ja mori 25 vende në Kuvend.
44. Pas zgjedhjeve në vitin 2007, Kryetari i Kosovës i propozoi Kuvendit z. Hashim Thaçi për Kryeministër, i cili mori mbështetjen e Kuvendit, në pajtim me nenin 9.1.26 (d) të Kornizës Kushtetuese.
45. Më 12 dhjetor 2010, Kosova mbajti zgjedhjet e përgjithshme parlamentare sipas Kushtetutës së tanishme, me ç'rast PDK-ja fitoi 32.11 % të votave, duke marrë 34 vende në Kuvend, LDK-ja fitoi 24.69 % të votave, duke marrë 27 vende në Kuvend, dhe Vetëvendosje fitoi 12.69 % të votave, duke marrë 14 vende në Kuvend.
46. Pas zgjedhjeve në vitin 2010, Ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës nominoi kandidat për Kryeministër z. Hashim Thaçi, i cili mori mbështetjen e Kuvendit më 22 shkurt 2011.

## **Meritat e kërkesës**

### **Argumentet e paraqitura nga parashtruesja e kërkesës**

47. Gjykata vëren se parashtruesja ka paraqitur argumentet në vijim:

*“Neni 84 i Kushtetutës renditë kompetencat kushtetuese të Presidentes. Siç është evidente, shumica e këtyre kompetencave lidhen me autoritetin për të emëruar kryesuesit e institucioneve të ndryshme publike, përfshirë por duke mos u kufizuar në gjyqësorin, forcat e sigurisë dhe misionet diplomatike. Emëruesi i përbashkët i këtyre kompetencave të Presidentes është fakti se – përderisa vendimi i Presidentes është përfundimtar - vet akti i emërimit është më shumë formal. Kjo për shkak se aktit të emërimit nga Presidentja i paraprinë një proces gjithëpërfshirës i verifikuar nga një institucion tjetër i mandatuar nga Kushtetuta, siç janë Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial ose Qeveria.*

*Duke marrë parasysh këtë dhe para parashtrimin të pyetjeve specifike lidhur me përputhshmërinë e nenit 84, paragrafi 14 me nenin 95 të Kushtetutës, kërkohet që Gjykata Kushtetuese të qartësojë natyrën e kompetencave të Presidentes për të emëruar dhe/ose mandatuar zyrtarët publikë për të ushtruar kompetencat e tyre të mandatuara me Kushtetutë sipas rendit tonë kushtetues, në përgjithësi, dhe në veçanti të qartësojë emërimin e kandidatit për Kryeministër pas zgjedhjeve? Përkatësisht, në këtë rast a është formale kompetenca e Presidentes në atë se certifikon se procesi, i cili i ka paraprirë aktit të emërimit, është zhvilluar në përputhje me Kushtetutën apo është thelbësore duke i mundësuar Presidentes të*



ushtrojë diskrecion (të plotë) në ushtrimin e kompetencave të lartpërmendura?

Lidhur me çështjen e mospërputhshmërisë, çështje kjo e cila ka nxitur parashtrimin e kësaj kërke, duhet të theksohet që nenit 84, paragrafi 14, i Kushtetutës parasheh se Presidentja “cakton mandatarin për formimin e qeverisë pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit që përbën shumicën e Kuvendit” [Theksi i shtuar}. Në anën tjetër, nenit 95, paragrafi 1, i Kushtetutës thotë “pas zgjedhjeve, Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon kandidatin për Kryeministër në konsultim me partinë politike ose koalicion që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”. Konflikti mes këtyre dy normave kushtetuese është i trefishtë. Përderisa teksti në nenin 84, paragrafi 14 i Kushtetutës është partia ose koalicioni “që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”. Mospërputhshmëria ndërmjet këtyre dy normave kushtetuese thellohet nga fakti se përderisa gjuha e nenit 84, paragrafi 1, të Kushtetutës është në kohën e tashme, gjuha në nenin 95, paragrafi 1, të Kushtetutës është në kohën e shkuar. Së fundi, përderisa gjuha sipas nenit 84, paragrafi 14, nuk përmban asnjë kualifikim, gjuha në nenin 95, paragrafi 1, kualifikohet me frazën “e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”.

## Vlerësimet e Gjykatës

48. Gjykata vëren se parashtruesi kërkon vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës dhe shtron pyetjet e renditura më lart.
49. Demokracia, “*vox populi*” (zëri i popullit), kërkon zgjedhjen e atyre që do të përfaqësojnë zërin e popullit në organin legjislativ të shtetit. Në një demokraci parlamentare, ky është subjekti më i lartë drejtues i veshur me një shumëllojshmëri të kompetencave, që në të njëjtën kohë i nënshtrohet parimit të ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit ndërmjet tyre. Një nga përgjegjësitë kryesore të parlamentit është që të vendosë duke votuar se kë të fuqizojë me funksione ekzekutive. Qeveria rrjedh nga fuqia mbizotëruese politike brenda parlamentit dhe i ka rrënjët në forcën politike që fiton zgjedhjet. Kjo mund të jetë një fitore absolute apo relative.
50. Siç shihet më lart, secili shtet ka dispozitat e veta juridike, të përcaktuara në Kushtetutë, në ligje ose në instrumente të tjera juridike lidhur me këto çështje.
51. Gjykata vëren se, kur dispozitat kushtetuese nuk janë të qarta, një nga mundësitë e interpretimit është që t’i kthehemi *Travaux Preparatoires* në mënyrë që të kuptojmë më mirë se si dhe pse hartuesit kanë formuluar tekstin e këtyre dispozitave kushtetuese ashtu si është. Megjithatë, përkitazi me Kushtetutën, Gjykata kishte kërkuar më parë nga Kuvendi, në Rastin KO98/11, të 20 shtatorit 2011, që të ofronte *Travaux Preparatoires* të Kushtetutës. Gjykata kurrë nuk mori përgjigje.
52. Në rastin e tanishëm, Gjykata kërkoi përsëri nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të paraqesin *Travaux Preparatoires* të Kushtetutës në lidhje me nenin 84.14 dhe me nenin 95 të Kushtetutës. Më 20 qershor 2014, Sekretari i



Përgjithshëm iu përgjigj Gjykatës se ata nuk i kanë *Travaux Preparatoires* të Kushtetutës.

53. Për këtë arsye, në mungesë të *Travaux Preparatoires* të Kushtetutës, Gjykata duhet të interpretojë vetë, në përputhje me nenin 112 të Kushtetutës, se në çfarë mënyre është i autorizuar Presidenti i Republikës, sipas neneve të mësipërme të Kushtetutës, të caktojë kandidatin për Kryeministër dhe sipas cilës procedurë.

54. Neni 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] i Kushtetutës përcakton:

*“Presidenti i Republikës së Kosovës:*

*...*

*cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit;”*

*...*

55. Neni 95 [Zgjedhja e Qeverisë] i Kushtetutës përcakton:

*1. Pas zgjedhjeve, Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë.*

*2. Kandidati për Kryeministër, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit.*

*3. Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.*

*4. Nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Presidenti i Republikës së Kosovës, Brenda dhjetë (10) ditësh emëron kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë. Nëse as herën e dytë nuk zgjidhet Qeveria, atëherë Presidenti i Kosovës i shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre.*

*5. Nëse Kryeministri jep dorëheqjen ose për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë, Qeveria bie, dhe Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri, për të formuar Qeverinë.*

*6. Anëtarët e Qeverisë pas zgjedhjes, japin betimin para Kuvendit. Teksti i betimit rregullohet me ligj.*

56. Gjykata rithekson se juridiksioni i saj kryesor është përcaktuar në nenin 112 të Kushtetutës, që përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.*



*2. Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësiave të saj.”*

57. Gjykata vëren se, parashtruesja, ka ngritur në kërkesë pyetje të detajuara që dalin nga nevoja, sipas saj, për vlerësim kushtetues të përputhshmërisë së nenit 84 (14) me nenin 95 të Kushtetutës. Këto nene kanë të bëjnë me kompetencat e Presidentit të Republikës, respektivisht me procedurën që duhet ndjekur për formimin e Qeverisë pas zgjedhjeve të përgjithshme. Gjykata konsideron se është e mjaftueshme të bëhet interpretimi i nenit 84 (14) në lidhje me nenin 95 të Kushtetutës.
58. Në kuadër të autoritetit të vet sipas nenit 112 të Kushtetutës, Gjykata do të bëjë interpretimin e nevojshëm. Kështu, Gjykata do të respektojë shkronjën dhe frymën e Kushtetutës dhe parimet e demokracisë dhe të qeverisjes demokratike.

### **Funksioni dhe roli i Presidentit të Republikës**

59. Gjykata vëren se neni 83 i Kushtetutës i referohet statusit të Presidentit të Republikës me fjalët në vijim: *“Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës”*.
60. Për më tepër, në pajtim me nenin 4.3 të Kushtetutës, *“[...] Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësuesi legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë”*.
61. Gjykata rikujton se mandati i Presidentit të Republikës është i pacenueshëm për të siguruar respektim të parimit të ndarjes së pushteteve dhe për ta ruajtur sigurinë në rendin juridik dhe kushtetues (shih rastet KO29/12 dhe KO48/12, Amendamentet e propozuara kushtetuese të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe më 4 maj 2012, Aktgjykimi i 20 korrikut 2012).
62. Gjykata konsideron se disa nga kompetencat e Presidentit prekin shumë qartë jetën politike të vendit, sikurse ato që përmenden në tekstin e neneve të Kushtetutës, të cilat janë objekt i çështjes së kërkesës.
63. Duke pasur parasysh kompetencat e konsiderueshme të dhëna Presidentit të Republikës në bazë të Kushtetutës, Gjykata konsideron se është e arsyeshme që publiku të marrë me mend se Presidenti i tyre, që “përfaqëson unitetin e popullit” dhe jo interesat grupore ose interesat politike partiake, do t’i përfaqësojë të gjithë ata. Çdo qytetar i Republikës ka të drejtë të sigurohet për paanshmërinë, për integritetin dhe për pavarësinë e Presidentit të tyre. Kjo, për më tepër, kur Presidenti i Republikës ushtron kompetenca politike sikurse kur bën zgjedhjen ndërmjet kandidatëve konkurrentë nga koalicione të mundshme për t’u bërë Kryeministër (rasti KI47/10, parashtrues: Naim Rustemi dhe 31 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykimi i 28 shtatorit 2010).



64. Objekti i kërkesës së tanishme, në të vërtetë, ka të bëjë me kompetencat e Presidentit të Republikës, si kreu i shtetit dhe në përfaqësim të unitetit të popullit të Republikës së Kosovës, për të caktuar mandatarin për formimin e Qeverisë, në përputhje me procedurën që duhet ndjekur për formimin e qeverisë pas zgjedhjeve të përgjithshme.
65. Meqenëse nenet 84 (14) dhe 95 të Kushtetutës janë të ndërlidhura ngushtë, Gjykata do t'i interpretojë ato së bashku.

### **Interpretimi i nenit 84 (14) të Kushtetutës**

66. Teksti i nenit 84.14 të Kushtetutës autorizon Presidentin e Republikës të marrë pjesë në formimin e qeverisë së re. Neni numëron një sërë elementesh:
- (a) Presidenti cakton mandatarin për Kryeministër;
  - (b) Pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit;
  - (c) Që përbën shumicën në Kuvend.
67. Sa i përket pikës (a) *Presidenti cakton mandatarin për Kryeministër*, Gjykata konsideron se teksti i nenit është i qartë dhe i prerë: mandatarin për Kryeministër caktohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës me vendim në të cilin personi i caktuar përmendet në mënyrë eksplicite. Në lidhje me këtë, Gjykata përsërit se Ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, më 18 shkurt 2011, në bazë të nenit 84 (14), të nenit 90 dhe të nenit 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, si dhe të Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Nr. 231-2011, të 7 shkurtit 2011, nominoi “[...] mandatarin, z. Hashim Thaçi, mandatar për Kryeministër për formimin e qeverisë së Republikës së Kosovës”.
68. Sa i përket pikës (b) *Pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit*, Gjykata është e mendimit se propozimi për emërimin duhet të rrjedhë nga partia politike ose nga koalicioni i cili do t’ia paraqesë Presidentit të Republikës emrin e personit për mandatar për Kryeministër. Formulimi i përdorur e thotë qartë se emri i mandatarit duhet të propozohet nga partia politike ose nga koalicioni i regjistruar për të marrë pjesë në zgjedhje të përgjithshme. Si rezultat i kësaj, nuk është në diskrecionin e Presidentit të Republikës që ai/ajo me vetiniciativë të propozojë kandidatin e tillë.
69. Termi “parti politike”, i përmendur në nenin 84.14, është definuar në nenin 3 [Përkufizimet] dhe i referuar në nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-073, të 5 qershorit 2008, i cili parasheh:

*“Neni 3 [Përkufizimet]*

*Për qëllim të këtij ligji,*

*[...]*

*“Parti politike” do të thotë një organizim i individëve të cilët janë bashkuar vullnetarisht mbi bazën e ideve, interesit dhe pikëpamjeve të përbashkëta, me qëllim të ushtrimit të ndikimit dhe pasjes së përfaqësuesve të tyre të*



*zgjedhur në zyrë publike, ose siç e përcaktuar ndryshe me legjislacionin në fuqi;*

*[...].*

#### *Neni 17 [Partitë Politike]*

*“17.1 Partia politike mund të certifikohet për pjesëmarrje në zgjedhje nëse dëshmon se regjistrimi në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2004/11 nuk është nën pezullim.*

*17.2 Zyra e informon KQZ-në rreth statusit të regjistrimit të secilës parti politike aplikuese para përfundimit të procedurës së certifikimit.”*

70. Në dritën e këtyre dispozitave, Gjykata është e mendimit se partia politike e cekur në nenin 84 (14) duhet të jetë subjekt politik i regjistruar nga KQZ-ja dhe duhet të ketë kaluar pragun e përcaktuar nga KQZ-ja pas zgjedhjeve.
71. Për më tepër, termi “koalicion”, i përdorur në nenin 84 (14), i referuar në nenin 3 [Përkufizimet] dhe në nenin 18 [Koalicionet] të Ligjit për Zgjedhjet, parasheh si vijon:

#### *“Neni 3 [Përkufizimet]*

*Për qëllim të këtij ligji:*

*[...]*

*“Koalicioni” do të thotë koalicioni i dy ose më shumë subjekteve politike;*

*[...].*

#### *“Neni 18 [Koalicionet]*

*18.1 Koalicioni mund të certifikohet për të garuar në zgjedhje nën një emër, me kusht që përbëhet vetëm nga partitë politike që kanë të drejtë për t'u certifikuar sipas nenit 15.4 të këtij ligji.*

*18.2 KQZ-ja e trajton koalicionin si një subjekt politik të vetëm nga dita kur koalicioni është certifikuar nga ajo e deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve. Partia politike nuk mund të tërhiqet nga koalicioni pasi që të jetë certifikuar, derisa rezultatet e zgjedhjeve të certifikohen.*

*18.3 Pas shpërbërjes së koalicionit, secila nga partitë politike të regjistruara të cilat kanë qenë anëtare të koalicionit janë përgjegjëse për një ndarje të të gjitha borxheve të shkaktuara nga koalicioni në përpjesëtim me marrëveshjen për koalicionin, përfshirë gjokat e papaguara të ngarkuara nga KQZ-ja apo KZAP-i.*

*18.4 Partia politike që është anëtare e koalicionit nuk mund të marrë pjesë si anëtare në një koalicion tjetër apo si parti politike e veçantë në të njëjtat zgjedhje.*

*[...].”*

72. Në dritën e dispozitave të lartpërmendura, Gjykata konsideron se termi “koalicion”, në nenin 84 (14) të Kushtetutës, ka të bëjë me subjektet e pranuar politike, të cilat janë certifikuar nga KQZ-ja si “koalicion për të garuar në zgjedhjet përkatëse nën një emër” dhe që kanë kaluar pragun e përcaktuar nga KQZ-ja pas zgjedhjeve. Andaj, koalicionet, të cilat nuk janë certifikuar nga KQZ-ja, nuk kanë të drejtë, sipas nenit 84 (14), për të propozuar mandatarin për Kryeministër.
73. Sa i përket pikës (c) që përbën shumicën në Kuvend, Gjykata vëren se, në mënyrë që votuesit të hedhin votat e tyre, partia politike ose koalicioni, i cili, sipas ligjit të lartpërmendur, është regjistruar si subjekt zgjedhor, ka emrin e vet në fletëvotim, ka marrë pjesë në zgjedhje dhe ka kaluar pragun, ka të drejtë sipas nenit 84 (14) të Kushtetutës, të propozojë personin për mandatar për Kryeministër.
74. Në këtë drejtim, në tekstin e mëtejme, përdorimi i termave “parti politike ose koalicion”, kur përmenden në lidhje me nenin 84 (14) dhe me nenin 95, paragrafi 1 dhe 4, të Kushtetutës, nënkuptohet partia politike ose koalicioni që është regjistruar sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, merr pjesë si subjekt zgjedhor, është i përfshirë në fletëvotim të zgjedhjeve, e kalon pragun dhe, rrjedhimisht, fiton vende në Kuvend.
75. Kjo parti politike ose koalicion duhet të ketë shumicën në Kuvend. Sipas interpretimit të Gjykatës, “shumica” ka po të njëjtin kuptim siç aplikohet në jurisprudencën dhe në praktikën kushtetuese dhe se duhet të jetë në pajtueshmëri me parimet kushtetuese në një shoqëri demokratike. Shumica mund të jetë absolute, më shumë se gjysma e të gjitha vendeve në Kuvend, ose relative, pra më shumë vende se partitë e tjera politike ose koalicionet që janë regjistruar në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.
76. Gjykata rithekson se, më 12 dhjetor 2010, Republika e Kosovës mbajti zgjedhjet e përgjithshme parlamentare në bazë të Kushtetutës aktuale. Në bazë të rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve, PDK-ja nuk kishte shumicën absolute të vendeve në Kuvend.
77. Gjykata vëren se Ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës, në bazë të dispozitave kushtetuese dhe të rezultateve të zgjedhjeve, e caktoi z. Hashim Thaçin kandidat për Kryeministër nga PDK-ja, parti kjo që kishte fituar shumicën relative, pra më së shumti vende në Kuvend në krahasim me partitë e tjera politike që ishin regjistruar në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, që kishin marrë pjesë në zgjedhje dhe që kishin kaluar pragun.
78. Për më tepër, Gjykata vëren se Ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës, në Vendimin e tij për caktimin e kandidatit për Kryeministër, theksoi:



*“II. Mandatari i nominuar z. Hashim Thaçi në afatin më të shkurt kohor, ftohet të bëjë konsultimet e nevojshme me partitë politike për të formuar koalicionin për Qeverinë e re dhe të dalë me propozim para Kuvendit Republikës së Kosovës”.*

79. Si rrjedhojë, më 22 shkurt 2011, z. Hashim Thaçi mori mbështetjen si Kryeministër i Qeverisë së re me 65 vota për, 1 abstenim dhe 0 kundër, në seancën e jashtëzakonshme plenare.
80. Kriteri “që përbën shumicën në Kuvend”, nga neni 84.14 i Kushtetutës, duhet lexuar në lidhje me dispozitën e nenit 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, pra, partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e vendeve në Kuvend, pra numrin më të madh të vendeve.
81. Gjykata vëren se neni 95, paragrafi 1, merret me procedurën sipas së cilës Presidenti i propozon Kuvendit *“[...] kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*. Pra, në këtë nen mund të dallohen një sërë elementesh:
- (a) Presidenti i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër;
  - (b) në konsultim me partinë politike ose me koalicionin;
  - (c) që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend;
  - (ç) [e nevojshme] për të formuar Qeverinë.
82. Këto elemente janë kumulative dhe përbëjnë parakusht që Presidenti i Republikës të bëjë konsultimet e nevojshme me partinë ose me koalicionin që ka fituar shumicën e vendeve në Kuvend.
83. Sa i përket pikës (a) *Presidenti i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër*, Gjykata i referohet formimit të mëhershëm të Qeverisë, në vitin 2011, kur, me Vendimin e 18 shkurtit 2011, Ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës, z. Jakup Krasniqi, e nominoi në Kuvend z. Hashim Thaçi mandatar për formimin e Qeverisë, në bazë të rezultateve të certifikuara, të dërguara më 8 shkurt 2011 Ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës nga KQZ-ja dhe e propozoi atë, si të tillë, në Kuvend.
84. Sa i përket pikave (b) *në konsultim me partinë politike ose koalicionin* dhe (c) *që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend*, marrë si të kombinuara, Gjykata vëren se me Vendimin e lartpërmendur të Ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës, kandidati i nominuar gjithashtu ftohej të bënte konsultimet e nevojshme me partitë politike për Qeverinë e re, pasi partia e tij nuk kishte shumicën absolute në Kuvend. Lidhur më këtë, Gjykata rithekson se Presidenti i Republikës mund të konsultohet vetëm me partinë politike ose me koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, qoftë shumicën absolute, qoftë relative.
85. Sa i përket pikës (ç) *[e nevojshme] për të formuar Qeverinë*, Gjykata konsideron se shprehja “[e nevojshme] për të formuar Qeverinë” do të thotë se partia politike ose koalicioni që duhet të konsultohet është ajo që ka vende të mjaftueshme në Kuvend për të formuar shumicën. Pra, se a do të ketë partia



politike ose koalicioni votat e nevojshme për formimin e Qeverisë do të përcaktohet nga votimi në Kuvend.

86. Prandaj, Presidenti i Republikës nuk mund të parashikojë që partia politike ose koalicioni të cilën ai/ajo duhet ta konsultojë për nominim të mandatarit do të marrë shumicën e mjaftueshme të votave në Kuvend për të formuar Qeverinë e propozuar nga mandatarit. Prandaj, shprehja “[e nevojshme] për të formuar Qeverinë” ka të njëjtin kuptim sikurse në nenin 84 (14) të Kushtetutës, ashtu që partia politike ose koalicioni mund të jetë vetëm ajo që ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhje, respektivisht numrin më të madh të vendeve në Kuvend. Është e qartë, kjo parti ose ky koalicion ka marrë mbështetjen më të madhe nga votuesit për të qeverisur vendin.
87. Sidoqoftë, Gjykata vëren se nuk përjashtohet që partia ose koalicioni në fjalë do të refuzojë të marrë mandatin.
88. Rregulli dhe parimet demokratike, si dhe korrektësia politike, parashikueshmëria dhe transparenca, kërkojnë që partisë politike ose koalicionit që ka fituar numrin më të madh të vendeve, si rezultat i zgjedhjeve t’i jepet mundësia të propozojë kandidatin për Kryeministër për formimin e Qeverisë. Presidenti i Republikës nuk e ka diskrecionin të aprovojë ose të mos aprovojë nominimin e mandatarit nga partia ose nga koalicioni, por duhet të sigurojë caktimin e tij/saj.

#### **Interpretimi i nenit 95, paragrafi 4, të Kushtetutës**

89. Sa i përket interpretimit të nenit 95, paragrafi 4, Gjykata vëren se kjo dispozitë e precizon procedurën sipas së cilës Presidenti i Republikës emëron kandidatin tjetër për Kryeministër, duke ndjekur të njëjtën procedurë, nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr votat e nevojshme në Kuvend. Ky nen numëron dy elemente:
- (a) Presidenti emëron kandidatin tjetër;
  - (b) sipas së njëjtës procedurë.
90. Ky nen qëndron i heshtur në pyetjen se cila parti ose cili koalicion e propozon kandidatin e ri për Kryeministër. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, është në diskrecionin e Presidentit të Republikës që, pas konsultimeve me partitë dhe me koalicionet, të vendosë se cilës parti ose cilit koalicion do t’i jepet mandati për të propozuar kandidatin tjetër për Kryeministër.
91. Nuk duhet të përjashtohet që Presidenti i Republikës mund të vendosë t’i japë të njëjtës parti ose koalicion edhe një rast për të propozuar kandidatin tjetër, që mund të jetë i suksesshëm në formimin e Qeverisë së re, duke marrë votat e nevojshme në Kuvend.
92. Gjykata konsideron se Presidenti i Republikës duhet të vlerësojë se cila është gjasa më e madhe që një parti politike ose koalicion të propozojë kandidatin për Kryeministër, i cili do të marrë votat e nevojshme në Kuvend për formimin e Qeverisë së re.



93. Gjykata rithekson se neni 95, paragrafi 4, i Kushtetutës kërkon që të ketë një kandidat tjetër për Kryeministër, por e lë të hapur çështjen se cilës parti ose cilit koalicion do t'i jepet mandati për të propozuar kandidatin për Kryeministër.
94. Pasi që, sipas Kushtetutës, Presidenti i Republikës përfaqëson shtetin dhe unitetin e popullit, është përgjegjësi e Presidentit të ruajë stabilitetin e vendit dhe të gjejë kriteret mbizotëruese për formimin e qeverisë së re, në mënyrë që të shmangen zgjedhjet.
95. Prandaj, Gjykata konkludon se dispozitat kushtetuese janë mjaftueshëm të qarta dhe në përputhshmëri me njëra-tjetrën për të çuar deri te formimi i Qeverisë së re në pajtim me vullnetin e votuesve.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 84 (9) dhe të nenit 112 të Kushtetutës, si dhe të rregullit 56.1 të Rregullores së punës, më 30 qershor 2014,

### **VENDOS**

- I. Njëzëri, TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. Me shumicë votash, TË KONSTATOJË që:
- a. Nenet 84 (14) dhe 95 të Kushtetutës janë në përputhshmëri me njëri-tjetrin;
  - b. Përdorimi i termave “parti politike ose koalicion”, kur përmenden në lidhje me nenin 84 (14) dhe me nenin 95, paragrafët 1 dhe 4, të Kushtetutës, nënkupton partinë politike ose koalicionin që është regjistruar sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, merr pjesë si subjekt zgjedhor, është i përfshirë në fletëvotim të zgjedhjeve, e kalon pragun dhe, rrjedhimisht, fiton vende në Kuvend;
  - c. Partia ose koalicioni që ka fituar shumicën në Kuvend, siç përcaktohet në nenin 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, nënkupton partinë ose koalicionin që ka shumicën e vendeve në Kuvend, qoftë shumicën absolute, qoftë atë relative;
  - ç. Presidenti Republikës, në bazë të nenit 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër të nominuar nga partia politike ose nga koalicioni që ka numrin më të madh të vendeve në Kuvend;
  - d. Presidenti i Republikës nuk e ka diskrecionin të refuzojë caktimin e kandidatit të propozuar për Kryeministër;
  - dh. Në rast se kandidati i propozuar për Kryeministër nuk merr votat e nevojshme, Presidenti Republikës, në diskrecionin e tij/saj, në bazë të nenit 95, paragrafi 4, të Kushtetutës, emëron kandidatin tjetër për Kryeministër, pas konsultimit me partitë ose me

koalicionet (e regjistruara në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme) që kanë plotësuar kriteret e lartpërmendura, pra me parti ose me koalicion që është regjistruar si subjekt zgjedhor në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, e ka emrin në fletëvotim të zgjedhjeve, ka marrë pjesë në zgjedhje dhe ka kaluar pragun;

- e. Nuk përjashtohet që Presidenti i Republikës të vendosë t'i japë partisë ose koalicionit të parë, sipas nenit 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, mundësinë të propozojë kandidatin tjetër për Kryeministër;

III. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim palëve dhe ta publikojë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.


**Gjyqtarja raportuese**



Snezhana Botusharova



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani